

GJYKATASUPREME

Numri i lendes:

Pml.Kzz 8/2015

(P. Nr. 346/2012 Gjykata Themelore ne Peje)

(PAKR 102/2013 Gjykata e Apelit)

Data:

18 shkurt 2015

Gjykata Supreme e Kosoves, ne kolegin e perbere prej gjyqtares se EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova (kryetare e kolegit dhe gjyqtare raportuese), dhe gjyqtarit te EULEX-it Willem Brouwer dhe gjyqtares se Gjykates Supreme Valdete Daka si anetare te kolegit, me ndihmen e zyrtares ligjore te EULEX-it Elise Svenkerud Thoen ne cilesi te procesmbajteses, ne lenden penale me numer P. Nr. 346/2012 para Gjykates Themelore te Pejes kunder:

1. N.M., emri i babait, emri dhe mbiemri i vajzerise i nenes ..., i lindur me ***** ne fshatin ***, Komuna e ***, mashkull, i nacionalitetit Boshnjak, shtetas i Kosoves, numri i leternjoftimit *****, avokat, ish- ****, me diplome universitare, ka te kryer edhe provimin e jurisprudences ne Prishtine, me gjendje te dobet ekonomike, i martuar ka tre femije, vendbanimi i fundit ne liri ne rrugen *** nr. *** ne ***, ***, i denuar per vepra penale te **keqperdorimit te pozites apo autoritetit zyrtar** ne kundershtim te nenit 422 (1) te Kodit Penal te Kosoves (KPK) (i zbatueshem ne perputhje me nenin 3(2) te KPK-se si ligji me i favorshem) dhe **shperdorimi i pozites zyrtare ose i autorizimit** ne kundershtim te nenit 339 (1) te KPK-se, dhe e denoi me denim unik me tre (3) vjet e gjashte(6) muaj burgim si dhe me nje denim plotesues me ndalim te ushtrimit te flinkzionit publik per nje periudhe tre (3) vje?are pas vuajtjes se denimit me burgim;

2. R.Z., emri i babait ..., emri dhe mbiemri i vajzerise i nenes..., i lindur me ***** ne ***, mashkull, shqiptar i Kosoves, shtetas i Kosoves, drejtore *****, me gjendje mesatare ekonomike, i martuar ka 2 femije, vendbanimi i fundit ne liri ne rrugen **** nr. *** ne Gjakove, Kosove, i denuar per vepra penale te **ushtrimit te ndikimit** ne kundershtim te nenit 354 (1), ne lidhje me nenin 23 te Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves (KPPK-se), dhe **nxitje per keqperdorim te pozites apo autoritetit zyrtar** ne kunuerslitim te nenit 422 (1), ne lidhjem^nenin 31 dhe 32 te KPK-se (i zbatueshem ne perputhje me nenin 3(2) te KPK^se si ligi mSi favorshem) dhe jane denuar me denim unik me tre (3) vjet e gjashte (6) muaj burgim:

3. X. Z., emri I babait ..., emir dhe mbiemri I vajzerise se nenes ..., I lindur me *** ne Gjakove, mashkull, shaiptar I Kosoves, shtetas I Kosoves, inxhinier i makinerise, i diplomuar ne shkolle te larte, me gjendje shume te dobet ekonomike, i martuar ka tre (3) femije, vendbanimi i fundit ne liri ne rrugen *** nr.*** ne ***, Kosove, i denuar per vepra penale te **ushtrimit te ndikimit** ne kundershtim-te nenit 354 (1), ne lidhje me nenin 23 te Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves (KPPK-se), dhe **nxitje per keqperdorim te pozites apo autoritetit zyrtar** ne

kundershtim te nenit 422 (1), ne lidhje me nenin 31 dhe 32 te KPK-se (i zbatueshem ne perputhje me nenin 3(2) te KPK-se si ligji me i favorshem) dhe jane denuar me denim unik me tre (3) vjet e gjashte (6) muaj burgim;

*duke vepruar sipas kerkesave per mbrojtje te ligjshmerise te paraqitura nga i pandehuri N. M. me *****, dhe nga i pandehuri R.Z. me 18 gusht 2014, nga i pandehuri X.Z. me 18 gusht 2014 dhe nga avokati mbrojtes K.S. ne emer te X.Z. me 17 shtator 2014.*

pas shqyrtimit te pergjigjes ndaj kerkesave, te paraqitur nga Prokuroria e Shtetit me 23 janar 2015;

pas mbajtjes se keshillimit dhe votimit me 18 shkurt 2015

ne perputhje me nenin 418 dhe nenet 432-441 te Kodit te Procedures Penale (KPP)

leshon kete

AKTGJYKIM

Kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise te paraqitura nga i pandehuri N.M. me 5 gusht 2014, nga i pandehuri R.Z. me 18 gusht 2014, nga i pandehuri X.Z. me 18 gusht 2014 dhe nga avokati mbrojtes K.S. ne emer te X.Z. me 17 shtator 2014 kunder aktgjykimit te dates 23 maj 2013, ne 9eshtjen me numer P nr. 346/12 te Gjykates themelore te Pejes, te konfirmuar me aktgjykimin e dates 6 qershor 2014, ne qeshtjen me numer PAKR 413/13 te Gjykates se Apelit, refuzohen si te pabazuara.



ARSYETIMI

1. Historia e procedures

1.1. Me 31 korrik 2012 Prokurori i Qarkut i EULEX-it ngriti aktakuzen PPS. 114/2012 kunder te pandehurve, e cila u konfirmua me ane te aktvendimit per konfirmim te aktakuzes KA 228/12 te dates 17 shtator 2012, te ndryshuar me 4 dhjetor 2012. Shqyrtimi gjyqesor filloj me 3 dhjetor 2012 ne Gjykaten e Qarkut ne Peje.

1.2. Me 23 maj 2013 Gjykata Themelore ne Peje leshoi aktgjykimin P nr. 346/12 me te cilin shpall fajtor te pandehurin N.M. per veprat penale te keqperedorimit te pozites apo autoritetit zyrtar ne kundershtim te nenit 422 te KPK-se, shperdorimi i pozites zyrtare ose i autorizimit ne kundershtim te nenit 339 (1) te KPK-se mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve ne kundershtim te nenit 374 paragrafit lte KPRK-se, dhe e denoi me denim unik me pese vjet burgim, brenda (tridhjete) 30 ditesh, si dhe me nje denim plotesues me ndalim te ushtrimit te funksionit publik per nje periudhe tre vje9are pas vuajtjes se denimit me burgim. Te pandehurit R.Z. dhe X.Z. te dyte jane shpallur fajtore per veprat penale te ushtrimit te ndikimit ne kundershtim te nenit 354 paragrafit, ne lidhje me nenin 23 te KPPK-se, nxitje per keqperedorim te pozites apo autoritetit zyrtar ne kundershtim te nenit 422 paragrafit 1, ne lidhje me nenin 31 dhe 32 te KPK-se, dhe jane denuar me denim unik me kater vjet burgim dh me gjobe ne shume prej 10,000 (dhjetemije) euro secili, qe duhet te paguhen brenda (tridhjete) 30 ditesh. Gjykata Themelore po ashtu ka konfiskuar asete nga R.Z. dhe X.Z. dhe nje arme me fisheke nga N.M..

1.3. Me 6 qershor 2013 Gjykata e Apelit ka leshuar aktgjyimin PAKR 413/13 me te cilin pjeserisht pranohen ankesat e paraqitura ne emer te te pandehurve. Me aktgjyimin e shkalles se pare N.M. eshte denuar me denim unik me tre vjet e gjashte muaj burgim, si dhe me nje denim plotesues me ndalim te ushtrimit te funksionit publik per nje periudhe tre vjet are pas vuajtjes se denimit me burgim; kurse pika e mbajtjes ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve ne kundershtim te nenit 374 paragrafit te KPRK-se eshte hedhur poshte ne perputhje me nenet 2.1 dhe 3.1.1.10 te Ligjit nr. 04/L-209 per Amnisti. R. dhe Xh.Zh. te dyte u denuan me denim unik me tre vjet e gjashte muaj burgim. Eshte hequr edhe masa e konfiskimit te disa gjerave gjate bastisjes es shtepise se R. dhe X.Z.. Ankesat jane refuzuar ne te gjitha aspektet e tjera dhe aktgjykimi i apeluar eshte vertetuar.

1.4. Me 5 gusht 1014 dhe 16 tetor 2014 i pandehuri N.M. paraqiti kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates se Apelit e cila eshte plotesuar me 16 tetor 2014. Me 18 gusht 2014 dy te pandehurit R. dhe X.Z. paraqiten kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates Themelore te Pejes dhe te Gjykates se Apelit. Me 17 shtator 2014 avokati mbrojtues i te pandehurit X.Z. paraqiti kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates Themelore te Pejes.

1.5. Me 23 janar 2015 Prokuroria e Shtetit ka paraqitur per^jigje ndaj kerkesave per mbrojtje te ligjshmerise.

2. Parashtresat e paleve

Kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise te paraqitura nga i pandehuri N.M.:

2.1. Me 5 gusht 1014 (e plotesuar me 16 tetor 2014) i pandehuri N.M. paraqiti kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates se Apelit ne baze te shkeljes se procedures penale dhe ne baze te vendimit per sanksionin penal. Fillimisht i pandehuri pretendon se trupi gjykues nuk kishte perberje te duhur pasi disa anetare te trupit gjykues kishin marre pjese ne procedure paraprake. Se dyti, i pandehuri pretendon se procedura eshte dashur te zhvillohet ne baze te dispozitave te Kodit te Procedures Penale te Kosoves te 1 janarit 2013 dhe jo sipas Kodit te vjeter te Procedures Penale. Se treti, i pandehuri pretendon se deshmia e deshmitarit P.M. eshte dashur te shpalije e papranueshme duke u bazuar ne shkeljet e dispozitave te kane te bejne me atributin e statusit te deshmitarit bashkepunues. I pandehuri si pike te katert pretendon se aktgjykimi i Gjykates se Apelit ka tejkaluar aktakuzen duke bere shkelje te Kodit te Procedures Penale. Ne fund, i pandehuri pretendon se denimi i shqiptuar nga Gjykata e Apelit ishte shume i rende dhe se Gjykata nuk ka arritur ta rivendos denimin plotesues kur ka bere ndryshimin e aktgjykimit te Gjykates Themelore.

Kerkesat per mbrojtje te ligishmerise te paraqitura nga te pandehurit R. e X.Z.:

2.2. Me 18 gusht 2014 dy te pandehurit R. dhe X.Z. paraqiten kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates Themelore te Pejes dhe te Gjykates se Apelit ne baze te shkeljes se procedures penale. Te pandehurit pretendojne se trupi gjykues si ne Gjykaten Themelore ashtu edhe ne Gjykate te Apelit nuk ishin ne perbetje te duhur pasi disa anetare te trupit gjykues kishin marre pjese ne procedure paraprake.

Kerkesat per mbrojtje te ligishmerise te paraqitura nga avokati mbroites i X.Z.

2.3. Me 17 shtator 2014 avokati mbrojtes i te pandehurit X.Z. paraqiti kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder aktgjykimit te Gjykates Themelore te Pejes ne baze te shkeljes se ligjit penal. Avokati mbrojtes parashtron se eshte shkelur ligji penal sepse i pandehuri eshte denuar e nuk eshte liruar nga Gjykata edhe pse nuk eshte deshmuar se ka kryer veprat penale per te cilat eshte akuzuar. Mbi kete baze avokati mbrojtes i referohet parimit *in dubio pro reo* dhe pohon se per shkak te asaj qe e konsideron si gjendje te dyshimte faktike, Gjykata eshte dashur te vendoste ne favor te te pandehurit. Avokati mbrojtes po ashtu permend deshmine e deshmitarit bashkepunues dhe sugjeron se ka mjaft kunderthenie ne deshmine e tij qe m VesHtifest i gjykates te konsideroje kete deshmi si te besueshme ne menyre objekjive dhe te arsyeshm. Avokati mbrojtes i referohet nenit 157 paragrafit 4 te KPPK-se, i cili pprcakton se gjyfcatjj nuk e shpallo personin fajtor vetem mbi bazen e deshmise se dhene pga deshmitari bashkepunues.

Pergjigja e Zyres se prokurorit te Shtetit

2.4. Me 23 janar 2015 Prokuroria e Shtetit ka paraqitur pergjigje ndaj kerkesave per mbrojtje te ligjshmerise. Prokurori i Shtetit parashtron se shumica e pretendimeve qe jane ngritur ne kerkesa ishin ngritur edhe me heret ne fazat e meparshem te procedures sa i perket aktgjykimit te Gjykates themelore te Pejes dhe jane refuzuar si te pabazuara. Prokurori i Shtetit i referohet argumenteve te mendimit te meparshem te Prokurorit te Apelit te dates 13 nentor 2013 si pjese integrate e pergjigjes.

2.5. Lidhur me pretendimin e ngritur nga te pandehurit se trupi gjykues nuk ishte ne perbeije te duhur, Prokurori i Shtetit i referohet aktgjykimit te leshuar nga Gjykata e Apelit ku gjykata kishte trajtuar kete pretendim ne hollesi dhe ku kishte ofruar nje shtjellim te qarte te bazave ligjore ne mbeshtetje te konstatimit se nuk kishte asnje shkelje te procedures. Prokurori i Shtetit pohon se pajtohet me gjetjet e Gjykates dhe konsideron se pretendimi i te pandehurve eshte i pabazuar.

2.6. Lidhur me pretendimin e dyte te ngritur nga i pandehuri M. se procedura eshte dashur te zhvillohet ne baze te dispozitave te Kodit te Procedures Penale te Kosoves te 28 dhjetorit 2012 (KPK), Prokurori i Shtetit gjen se ky pretendim eshte pa merite. Ai veren se shqyrtimi gjyqesor ka filluar me 3 dhjetor 2012 gjersa ende ishte ne fuqi kodi i vjeter i procedures penale (KPPP) dhe se perfimdimi eshte arritur ne baze te ketij Ligji ne perputhje me mendimin juridik te Gjykates Supreme nr. 56/2013 te dates 23 janar 2013. Prokurori i Shtetit argumenton se edhe pse eshte jokontestuese qe gjyqtaret jane te pavarur ne ushtrimin e fimksioneve te tyre ne baze te ligjit ne fuqi, Gjykata Supreme eshte organi me i larte gjyqesor ne Kosove ne baze te ligjit nr. 3/L-199 per Gjykatat, dhe percakton parimet dhe qendrimet dhe mjetet juridike per qeshtjet me rendesi per zbatimin e unifikuar te ligjeve nga gjykatat ne tere territorin e Kosoves.

2.7. Lidhur me pretendimin e trete te ngritur nga i pandehuri M. se deshmia e deshmitarit P.M. eshte dashur te shpaljej e papranueshme duke u bazuar ne shkeljet e dispozitave te kane te bejne me atributin e statusit te deshmitarit bashkepunues, Prokurori i Shtetit gjen se ky pretendim eshte pa merite dhe i referohet gjetjes se Gjykates se Apelit qe keto qeshtje i ka adresuar ne aktgjykimin e saj.

2.8. Lidhur me pretendimin e katert te ngritur nga i pandahuri M. se aktgjykimi i Gjykates se Apelit ka tejkaluar aktakuzen, Prokurori I Shtetit gjen se i pandehuri nuk ka arritur t'i siguroje bazat per kete pretendim, dhe gjen s eky pretendim eshte pa merite. Dhe ne fund, sa i perket pretendimit te peste te ngritur nga i pandehuri M. lidhur me denimin e shqiptuar kunder tij, Prokurori i Shtetit gjen se denimi eshte adekuat per rrethanat e rastit dhe per nivelin e perjegjesise penale.

3. Kompetenca e kolegjit

3.1. Ligji Nr 04/L-273 per ndryshimin dhe plotesimin e ligjeve qe nderlidhen me mandatin e misionit te Bashkimit Evropian per sundimin e ligjit ne Republiken e Kosoves, (tash e tutje "*Ligji Omnibus* "), i miratuar me 23 prill 2014 i cila ka hyre ne fuqi me 30 maj 2014 *nder te tjera* ka ndryshuar Ligjin Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, perzgjedhjen e lendeve dhe caktimin e lendeve te gjyqtareve dhe te prokuroreve te EULEX-it ne Kosoves (tash e tutje "*Ligji mbi Kompetencat*") rregullon kompetencen e gjyqtareve te EULEX-it qe ka te beje me kompetencen e gjykates.

3.2. Kolegji vendosi njezeri se kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise te paraqitura nga te pandehurit duhet te konsiderohen si "raste ne proces" ne perputhje me nenin 1.A te Ligjet Omnibus, prandaj gjyqtaret e EULEX-it kane kompetence ne kete queshtje.

4. Gjetjet e kolegjit

A. Gjetjet e pergjithshme

4.1. Kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise te paraqitura nga te pandehurit dhe nga avokati mbrojtësi dhe perjigja e Prokurorit te Shtetit jane te paraqitura me kohe dhe te pranueshme.

4.2. Te pandehurit dhe avokatet mbrojtës kane ngritur një numer te madh queshtjesh. Sidoqofte, Gjykata Supreme veren se shumica e parashtresave jane thjesht vetem perseritje e queshtjeve qe ishin ngritur ne ankesat kunder aktgjykimit te shkalles se pare, te cilat Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar ne plotesi dhe me kujdes. Te pandehurve dhe avokateve mbrojtës u behet me dije se kerkesa per mbrojtje te ligjshmerise mund te paraqiten mbi bazën e slikejës se ligjet penal, mbi bazën e shkeljeve te caktuara esenciale te dispozitave te procedures penale, ose ne rast te shkeljeve te tjera te dispozitave te procedures penale qe kane ndikuar ne ligjshmerine e vendimit gjyqesor. Kerkesa per mbrojtje te ligjshmerise nuk mund te paraqitet mbi bazën e vertetimit te gabuar dhe jo te plete te gjendjes faktike (neni 432 i KPP-se). Eshte perhapur një tendencë e pavend ne mesin e shume avokateve mbrojtës per ta shfrytezuar kerkesen per mbrojtje te ligjshmerise sian&eje dyte, gje qe nuk duhet te ndodhe. Prandaj Gjykata Supreme gjen se do pretendim i bere lidftur me bazat e vertetimit e gabuar dhe jo te plete te gjendjes faktike duhet te hedhet poshtë si e papranueshme.

I

B. Ceshtje e perjashtimit te gjyqtareve

4.3. Disa nga gjyqtaret ne shqyrtim gjyqesor ne Gjykaten Themelore te Pejes kishim marre pjesë edhe me pare ne marrjen e vendimeve lidhur me paraburgimin. Te gjithe te pandehurit pretendojne se keta gjyqtare eshte dashur te perjashtoheshin nga shqyrtimi gjyqesor ne perputhje me nenin 40 (2) te KPP-se.

4.4 Neni 40 (2) i KPPK-se percakton se gjyqtari perjashtohet [...] nga trupi gjykues kurper rastin e njejtë penal ose ne rastin kunder te pandehurit te njejtë ka marre pjesë ne procedure paraprake,

dukeperjshire edhe proceduren per konfirmimin e aktakuzes [...]. Neni 40 (2) i KPP-se i referohet pejashtimit te gjyqtareve nen nenin 39 i cili ne paragrafin 2 percakton se gjyqtari perjashtohet si gjyqtar i vetem gjykues, kryetar i trupit gjykues, anetar i trupit gjykues, anetari i kolegjit te apelit apo kolegjit te Gjykates Supreme nese ka marre pjese ne procedura te mehershme ne te njejtin rast penal [...]

4.5. Gjykata Supreme veren se anetaret te shqyrtimit gjyqesor ne Gjykaten Themelore te Pejes kishim marre pjese ne rastet ne vijim:

- Gjyqtari Malcolm Simmons ishte kryetar i kolegjit ne vazhdimin e paraburgimit (KP nr. 57/12);
- Gjyqtari Darius Sielicki ka kryesuar kolegjin per vazhdimin e paraburgimit (KP nr. 50/12) si dhe ka marre pjese ne kolegjin i cili ka trajtuar ankesen mbi ekspertizen (PP nr. 43/12); dhe
- Gjyqtarja Elmaze Syka ka qene anetare e kolegjit per vazhdimin e paraburgimit (KA nr. 228/12 PPS nr. 114/12), si dhe ka qene ne kolegjin i cili ka hedhur poshte ankesen e Prokurorit me te cilen kerkonte qe te pandehurit mos t'i lejohet qe te pranoj vizitore (KP nr. 68/12).

4.6. Me tutje, anetaret e kolegjit ne proceduren e apelit ne Gjykaten e Apelit kane marre pjese ne lenden ne vijim:

- Gjyqtari Tore Thomassen ka kryesuar kolegjin per vazhdimin e paraburgimit dhe ka qene anetar i kolegjit i cili ka vendosur lidhur me ankesen e Prokurorit kunder aktvendimit per zevendesimin e paraburgimit me dorezani, duke pranuar ankesen dhe duke ndryshuar kete aktvendim me rritjen e shumes se dorezanise (PK nr. 186/2013). Ai gjithashtu ka qene anetar i kolegjit i cili ka vendosur lidhur me ankesen e Prokurorit kunder urdhrit per kthimin e sendeve te konfiskuara tek te pandehurit. Anesa eshte pranuar dhe aktvendimi eshte ndryshuar duke mos ua kthyer te pandehurve gjerat e konfiskuara ((PN/KR 62/2013). Ai gjithashtu ka kryesuar kolegjin i cili ka vendosur lidhur me ankesen kunder aktvendimit mbi vazhdimin e paraburgimit ne Gjykaten Supreme >(P.n-Kr.Nr. 822/2012); dhe
- Gjyqtarja Tonka Berisha ka marre pjese ne kolegjin per vazhdimin e paraburgimit dhe ka qene anetare e kolegjit i cili ka vefidosur lidhur me ankesen e Prokurorise kunder aktvendimit

per zevendesimin e paraburgimit me dorezani, duke pranuar ankesen dhe duke ndryshuar kete aktvendim me rritjen e shumes se dorezanise (PK nr. 186/2013).

4.7. Qeshtja ne fjale ka te beje me ate nese keta gjyqtare "*kane marre pjese ne proceduren paraprake*" ne pajtim me nenin 40 (2) te KPPK-se dhe KPP-se per shkak te perfshiijes se tyre ne vendimet lidhur me paraburgimin etj. Kjo eshtje eshte shtjelluar gjate ne aktgjykimin e leshuar nga Gjykata e Apelit. Gjykata e Apelit i referohet dy aktgjykimeve te leshuara nga Gjykata Supreme e Kosoves ne vitin 2009 ku gjykata ka gjetur se vendimet mbi paraburgimin nuk konsiderohen pjesemarrije ne proceduren paraprake ne pajtim me ligjin. Ne lenden e pare te referuar¹, Gjykata Supreme ka theksuar se "*vendimet mbi aktivitetin e vegante te geshtjes se sigurise e cila bie jashte fazes specifike te procedures* Ne lenden e dyte te referuar², Gjykata Supreme ka theksuar se "*Kolegji ne fjale ka marre geshtjen e sigurise, duke vleresuar kushtet e paraburgimit [...] Gjyqtari nejjale nuk eshte leshuar fare ne meritat e lendes por vetem ka vleresuar kushtet eparaburgimit*". Gjykata e Apelit gjithashtu i eshte referuar nje lende te GjEDNj-se "Hauschmidt kunder Danimarkes" ku gjykata ka konstatuar se ne nje sistem te tille si te Danimarkes (i cili ka qene relevant ne lenden ne fjale) nuk mund te konsiderohet se fakti se nje gjyqtar ka marre pjese ne nje vendim ne proceduren paraprake ne vetvete arsyeton friken a paanshmerise sipas nenit 6 te Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut.

4.8. Ne baze te asaj qe u tha me lart, Gjykata Supreme gjen se dispozita e nenit 40 (2) te KPPK-se ne per gjithesi nuk i pejashton gjyqtaret te cilet kane marre pjese ne vendimet lidhur me paraburgimin. Sidoqofte, mbi bazen e te drejtes se te pandehurit sipas nenit 6 paragrafit 1 te KEDNj-seper *shqyrtim f...Jte drejte nga nje [...] gjykate epavarur*, Gjykata Supreme patjeter duhet te percaktoje nese ka ndonje aspekt subjektiv i cili tregon se gjyqtari ne lenden fjale, permes perfshirjes se tyre te meparshme ne lende, kane formuar nje mendim lidhur me ate nese te pandehurit jane fajtore per veprat e dyshuara penale. Pervec kesaj, gjykata patjeter duhet te vleresoje nese ka ndonje aspekt objektiv i cili tregon se gjyqtaret duhet te pejashtohen per shkak te perfshiijes se tij te meparshme ne kete lende.

4.9. Gjykata Supreme ka shqyrtuar me kujdes te gjitha vendimet procedurale te lartpermendura (ne lidhje me vazhdimin e masave kufizuese dhe te ngashme) ne te cilat gjyqtaret kane marre pjese para shqyrtimit gjyqesor, dhe nuk ka gjetur asnjë indikacion se ata kishin formuar ndonje mendim sa i perket meritave te lendes *p.sh.* nese te pandehurit jane faktore per kryerjen e veprave penale ne fjale. Per me teper, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë arsyje objektive se pse perfshirja e gjyqtareve ne

¹ Ap-Kz nr. 371/2008 i dates 10 prill 2009

² Pkl-Kzz 71/09 i dates 10 nentor 2009

3Sipas KOnventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut pavaresie e gjykates duhet te vleresohet pajeter perms testit subjektiv, I cili konsiston ne kerkim per te percaktuar binden personale ten je gjyqtari ne lenden e caktuar, permes testit objektiv, I cili konsiston ne vertetimin nese gjyqtari ka ofruar garanci te mjaftueshme per te perjashtuar cdo dyshim te arsyeshem ne lidhje me kete (cf. Padovani kunder Italise f.20 par. 25 dhe Tierce dhe te tjeret kunder San Marinos, f. 12 par. 75.

vendimet e lartpermendura do te duhet t'i perjashtoj ata. Pavec nese ka arsyre per te besuar se gjyqtaret tashme kane paragjykuar, per te cilen nuk ka asnje indikacion, paanshmeria e tyre duhet te konsiderohet e pakundershtueshme sic edhe eshte. Mbi kete baze, Gjykata Supreme gjen se pretendimi se gjyqtaret e lartpermendor do te duhet te perjashtohen eshte jomeritor.

C. Zbatimi i Kodit te Perkohshem te Procedures Penale

4.10. I pandehuri N.M. pohon se procedura eshte dashur te zhvillohej mbi bazen e dispozitave te Kodit te Procedures Penale te 13 dhjetorit 2012 dhe jo sipas Kodit te Perkohshem te Procedures Penale te 6 korrikut 2003.

4.11. Kapitulli XXXVIII i Kodit te Procedures Penale te Kosoves i 13 dhjetorit 2012 i cili ka hyre ne fuqi me 1 janar 2013 perfshire dispozitat kalimtare te Ligjit. Sipas Gjykates Supreme, sic eshte theksuar shprehimisht ne Mendimin Juridik nr. 56/2013 2013 (Seanca e Pergjithshme e Gjykates Supreme me 23 janar 2013) keto dispozita kalimtare duhet te interpretohen ne ate menyre qe procedurat penale te filluara para hyijes ne fuqi te ketij ligji, per te cilat ka filluar shqyrtimi gjyqesor por nuk ka perfimduar, dispozitat e Kodit te Perkohshem te Procedures Penale zbatohen pershtatshmerish derisa vendimi te behet i formes se prere.

4.12. Ky kolegji i Gjykates Supreme pajtohet me kete qendrim dhe mbi kete baze gjen se procedura penale eshte zhvilluar ne pajtim me ligjin e duhur te procedures.

D. Deshmitari bashkepunues

4.13. I pandehuri M. pretendon se deshmia e deshmitarit bashkepunues, P.M., eshte dashur te shpallet e papranueshme per shkak te shkeljes se dispozites ne lidhje me caktimin e statusit te deshmitarit bashkepunues.

4.14. Se pari, Gjykata Supreme veren se pretendimi i njejtë eshte paraqitur ne ankesen kunder aktgjykit te shkalles se pare, dhe Gjykata Supreme plotesisht pajtohet me vleresimin e Gjykates se Apelit ne lidhje me kete ceshtje. Sic eshte theksuar nga Gjykata e Apelit (nen titullin "Perdorimi i provave te papranueshme" paragrafi 1 i aktgjykit). Neni 298 i KPPK- se percakton se statusi i deshmitarit bashkepunues mund t'i caktohet nje te dyshuari apo te pandehuri per te cilin aktakuza akoma nuk eshte lexuar ne shqyrtimin gjyqesor. Edhe pse ligji percakton nje definicion specifik sa i perket cilesimit si i "dyshuar", ligji nuk e percakton nevojen per ndonje procedure formale per t'a caktuar dikujt kete status. Sipas nenit 151 (1) te KPPK-se i dyshuar eshte "*eshte personi per te cilin policia ose autoritetet e ndjekjes penale kane dyshim te arsyeshem se ka keyer veper penale por kunder te cilit procedura penale nuk ka filluar*". P.M. vete ka kontaktuar policine dhe ka pranuar se kishte paguar Prokurorin per t'i nderprere hetimet kunder tij. Prandaj, eshte e qarte se ai ne ate moment eshte bere i dyshuar per perfshirje ne aktivitetet kreiminale nen hetime. Rrjedhimisht, P.M. i ploteson kushtet e te "dyshuarit" sic eshtë përcaktuar me ligj.

4.15. Me tutje, sic eshte theksuar nga Gjykata e Apelit, edhe nese statusi i deshmitarit bashkepunues i eshte caktuar gabimisht P.M.t, deshmia e tij nuk ka mundur te kundershtohet si e papranueshme sepse nuk ka asnje dispozite ne ligj e cila shprehimisht e percakton kete pasoje.

4.16. N e baze te asaj qe u tha me lart, Gjykata Supreme gjen se pretendimi se deshmia e deshmitarit bashkepunues eshte dashur te shpallet e papranueshme per shkak te shkeljes se dispozitave ne lidhje me statusin e deshmitarit bashkepunues, eshte i pabazuar.

4.17. Ne lidhje me deshmitarin bashkepunues, avokati mbrojtës i Xh.ZH. i referohet nenit 157 paragrafit 4 te KPPK-se i cili percakton se gjykata nuk mund te shpall një person fajtor vetem mbi bazën e deshmise se dhene nga deshmitari bashkepunues. Ai thekson se ka kunderthenie te konsiderueshme ne deshmine e P.M.t te cilat e bejne te veshtire per gjykaten qe ne menyre objektive dhe te arsyeshme ta gjejne deshmine si te besueshme.

4.18. Gjykata Supreme thekson se nenit 157 paragrafi 4 i KPPK-se nuk vendos rregulla te metutjeshme per te specifikuar se fare lloji tjeter te provave vertetuese nevojiten, ose per cilat elemente apo fakte ne lidhje me vepren penale. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se kjo 9eshtje, nese jane paraqitur prova vertetuese te mjaftueshme, duhet te vleresohet ne secilin rast ndaras. Gjate vleresimit, trupi gjykues duhet te marre parasysh te gjitha provat e paraqitura ne lende si dhe besueshmerine e atyre provave.

4.19. Gjykata Themelore ka analizuar ne menyre gjitheperfshirese besueshmerine e deshmitarit bashkepunues dhe ka gjetur deshmine e tij bindese dhe te besueshme. Deshmia e deshmitarit bashkepunues mbeshtetet nga deklarata e disa deshmitareve te tjere. Avokati mbrojtës i referohet kunderthenieve te konsiderueshme ne deshmine e P.M.t, por deshton qe te pershkruaj se cilat jane keto kunderthenie te pretenduara. Prandaj Gjykata Supreme konstaton se kundershtimet mbi kete baze jane jomeritore dhe se nuk ekziston asnje shkelje e nenit 157 paragrafit 4 te KPPK-se.

E. In dubio pro reo

4.20. Avokati mbrojtës i X.Z. i referohet parimit *in dubio pro reo* dhe thekson se per shkak te asaj se ai e konsideron gjendjen faktike te dyshimte, gjykata eshte dashur te vendose ne dobi te te pandehurit.

4.21. Gjykata Supreme veren se neni 3 parografi 2 i KPPK-se percakton se "*medyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rendesishme, per çështjen ose per zbatimin e ndonje dispozite te ligjit penal sipas ketij Kodi interpretohen ne favor te te partdehurit dhe te drejtave te tij [...]*".

4.22. Eshte praktike e zakonshme per avokatet mbrojtës qe te thirren ne parimin *in dubio pro reo*. Shpeshhere pretendohet se kur provat e njerit deshmitar jane ne kunderthenie me ato te deshmitarit tjeter lidhur me faktin, atehere ekziston dyshimi, prandaj zbatimi i parimit *in dubio pro reo* i versionit te faktave ne dobi te te pandehurit duhet gjetur patjeter, duke çuar ne lirimin e tij. Gjykata Supreme veren se ky eshte nje keqkuptim i parimit.

4.23. Parimi do te thote se kur ka dyshime sa i perket **fajesise** se te pandehurit, ajo patjeter duhet te zgjidhet ne dobi te te pandehurit. I pandehuri nuk mund te shpallet fajtor nga gjykata kur ka dyshime

lidhur me fajesine e tij. Kjo nuk e kufizon trupin gjykues, si gjykues i fakteve, qe te vleresoje pro vat kunderthenese dhe te konstatoje se nuk kane asnje dyshim sa i perket gjetjeve te tyre.

4.24. Permbajtja esenciale e parimit *in dubio pro reo* mund te ilustrohet me vendimin mbi ankesen ne GjPNJ³ ne lenden *Prokurori kunder F.L., H.B. dhe I.M.*. Dhoma e Apelit ka konsideruar se parimi *in dubio pro reo*, si konkluzion i prezumimit te pafajesise dhe barres se te provuarit pertej gdo dyshimi te arsyeshem, zbatohet per gjetjet e nevojshme per shpalljen fajtor, si ato te cilat perbejne elementet e krimtit te akuzuar. Parimi esencialisht eshte vetem nje aspekt i kushtit qe fajesia duhet patjeter te vertetohet pertej cdo dyshimi te arsyeshem. Me tutje, parimi *in dubio pro reo* nuk zbatohet per provat individuale dhe gjetjeve te fakteve mbi te cilat aktgjykimi nuk mbeshtetet.⁴

4.25. Avokati mbrojtes thjesht i referohet vetem mungeses se provave kunder klientit te tij X.X, dhe ate qe ai konsideron qe jete gjendje faktike e dyshimte, por deshton qe ta mbeshtes kete pretendim me tutje. Gjykata Supreme eshte e mendimit se nuk ka pasur shkelje te parimit *in dubio pro reo*.

F. Pretendimi se aktgjykimi tejkalon aktakuzen

4.26.1 pandehuri N.M. pohon se aktgjykimi i Gjykates se Apelit tejkalon aktakuzen, keshtu duke shkelur KPP-ne.

4.27. Ky pretendim gjithashtu eshte ngritur nga avokati mbrojtes i N.M.t ne ankesen kunder aktgjykimit te shkalles se pare, dhe eshte adresuar ne hollesi nga Gjykata e Apelit nen titullin "Aktgjykimi tejkalon aktakuzen (Neni 403 (1) (10) i KPP-se)". Gjykata Supreme plotesisht pajtohet me gjetjet e Gjykates se Apelit dhe i referohet aktgjykimit te saj ne lidhje me kete ceshtje. Gjykata Supreme veren se, *sic* eshte theksuar nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri thekson ne kerkesen e tij se "*mund te shihet qarte se aktgjykimi tejkalon pershkrimin e fakteve se [...] aktakuza permban [...]*" pa dhene asnje arsye konkrete lidhur me bazen e pretendimit te tij. Aktgjykimi as nuk e tejkalon gjendjen faktike te veprave te

³Prokurori hinder F.L., H.B. I.M., IT-03-66-|A, Aktgjykimi, 27 shtator 2007

⁴Gjykata Nderkombetare per Ndrekjen Penale te personave Pergjegjes Per Shkelje te se Drejtës Humanitare te Kryera ne Territorin e ish Jugosllavise qe ngajviti 1991

⁵ Prokurori Kunder F.L., H.B., I.M., IT-03-66-A, Aktgjykimi, 27 Shtator 2007

⁶ Shih faqen 11 te aktgjykimit IT-03-66-A.

akuzuara, e as nuk permban cilesime juridike te atyre veprave, te dhena nga Prokurori dhe te adresuara ne menyre joadekuate nga gjykatat e instancave me te uleta. Perveç kesaj, siç eshte verejtur nga Gjykata e Apelit, shqiptimi i denimit plotesues eshte element i brendshem i denimit. Mbi kete baze, Gjykata Supreme gjen se duhet te refuzohet si e pabazuar.

G. Pretendimi se denimi i shqiptuar eshte teper i ashper

4.28. I pandehuri M. perfindimisht pretendon se denimi i shqiptuar eshte teper i ashper.

4.29. Shumica e kolegjit te Gjykates Supreme⁵gjen se per shkak te kufizimit te arsyeve per te cilat mund te paraqitet kerkese per mbrojtje te ligjshmerise siç eshte percaktuar me nenin 432 te KPPK-se, vendimi mbi denimin mund te kundershtohet me kerkese per mbrojte te ligjshmerise vetem nese gjykata me rastin e leshimit te vendimit te siç ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore te cilat do te perbenin shkelje te ligjit penal. Eshte e qarte se ne rastin ne tjale kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, shumica e kolegjit gjen se ky pretendim duhet te hedhet poshte si i papranueshem.

H. Perfundim

4.30. Kerkesa patjeter duhet te refuzohet.

Pergatitur ne gjuhen angleze, gjuhe e autorizuar.

Kryetare e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtese

Elise Svenkerud Thoen

Zyrtare ligjore e EULEX-it

⁷ Mendimi i ndare mospajtues i kryetares se kplegjit Elka Frlicheva-Erjnenkova lidhur me kete geshtje i eshte bashkangjitur ketij aktvendimi.

v\ \, **Anetaret e kolegjit**

Willem Brouwer Gjyqtar i

EULEX-it

Valdete Daka

Gjyqtare e Gjykates Supreme

Mendim i ndare mospajtues i gjyqtares raportuese Elka Filcheva-Ermenkova ne lidhje me geshtjen nese denimi i shqiptuar mund te ndryshohet ne proceduren e kerkeses per mbrojtje te ligjshmerise:

Une nuk pajtohem me shumicen e kolegjit se denimi i shqiptuar nuk mund te adresohet ne proceduren e kerkeses per mbrojtje te ligjshmerise.

Sipas nenit 432 (1.1) te KPPK-se kerkese per mbrojtje te ligjshmerise kunder vendimit te formes se prere mund te paraqitet mbi bazen e shkeljes se ligjit penal {neni 432 (1.1)}; mbi bazen e shkeljes substancial te dispozitave te procedures penale te percaktuar me nenin 384, paragrafin 1 te ICPPK-se {(neni 432 (1.2) *ibid*} dhe mbi bazen e shkeljeve tjera te dispozitave te procedures penale nese shkelja e tille ka ndikuar ne ligjshmerine e vendimit gjyqesor {(neni. 432 (1.3) *ibid*}.

Lidhur me shkeljet e mundshme procedurale te shkaktuara ne proceduren e kerkeses per mbrojtje te ligjshmerise ligji i referohet listes se percaktuar per proceduren e ankeses sipas nenit 384(1) *ibid*.

Lidhur me shkeljet e mundshme te ligjit material, kodi i procedures nuk i referohet ne menyre strikte nenit 385 *ibid*, te zbatueshem per proceduren e ankeses. Prandaj, vetem interpreting gramatikor i ligjit et procedures mbeshtet mendimin se jo vetem shkeljet e ligjit penal material, si? eshte percaktuar me nenin 385 *ibid* mund te paraqesin baze per paraqitjen e kerkeses per mbrojtje te ligjshmerise, por gjithashtu edhe shkeljet te ligjit material penal, qe nuk jane permendor shprehimisht. Kurdo qe gjykata deshton qe te percaktoje denimin sakte, pa e tejkaluar autoritetin e saj sipas ligjit {qe eshte hipoteze specifike nen nenin385 (1.5)} gjykata ben shkelje te ligjit penal material. Prandaj, nuk ka asnje pengese per Gjykaten Supreme ne kete procedure qe te adresoje percaktimin e denimit, ne qofte se eshte e nevojshme. Nje argument tjeter ne favor te ketij qendrimi eshte fakti se ligjvenesi gjate perkufizimit te juridiksionit te Gjykates Supreme ne proceduren e kerkeses per mbrojtje te ligjshmerise shprehimisht ka pejashtuar mundesine qe GjS te shqyrtoje faktet e vertetuara nga gjykatat e instancave me te uleta {(neni 432 (2) *ibid*} por ligjvenesi nuk ka perjashtuar shprehimisht rishikimin e denimit te shqiptuar, qe eshte geshtje e zbatimit te drejte te ligjit penal material, si eshte verejtur tashme. Sidoqofle, ne lenden ne fjale nuk eshte verejtur nje zbatim i gabuar, dallimi ne mendime nuk to te kishte cuar ne nje rezultat tjeter.

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e EULEX-it

D /